

Çdo person gëzon të drejtën e njohjes së një informacioni publik apo të një ankese drejtuar autoriteteve publike, ne përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi. Në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” për dërgimin e një kërkesë ose ankese përdoret adresa postare, si vijon: Adresa: Rruga e Dibrës 372 Tirana AL, 1000. Kërkesa mund të dërgohet edhe nëpërmjet komunikimit elektronik [e-mail: info@qsut.gov.al](mailto:info@qsut.gov.al), apo paraqitjes në zyrën e informacionit dhe plotësimit të formularit përkatës. Të gjitha kërkesat dhe ankesat trajtohen në bazë të legjislacionit në fuqi duke respektuar afatet ligjore të parashikuara në Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Kodin e Procedurave Administrative apo kur parashikohet ndryshe nga ligjet e posaçme.